



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.: 1715/24 Datë: 20/08/2024

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/l-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe referuar procesverbalit të mbledhjes së 127-të, mbajtur me datë 12.08.2024, Këshilli Shtetëror i Cilësisë, mori:

V E N D I M

I. Zgjatet periudha e riakreditimit të programit të arteve në Universitetin “Haxhi Zeka” në Pejë për periudhën një (1) vjeqare nga 01.10.2024 deri 30.09.2025, për programin e studimit:

- *Edukim në Muzikë Bachelor i Arteve 240 ECTS (R)*

II. Për këtë periudhë të riakreditimit vlejné kriteret dhe kuotat e njëjta sikurse në vendimin e fundit të KShC-së Ref.3025/21 datë 12.08.2021, me të cilin ishte ri/akredituar programi si në par. I të këtij vendimi.

III. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A R S Y E T I M

Universiteti “Haxhi Zeka” në Pejë brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim, për riakreditimin e programeve të studimit me stafin akademik si në tabelë:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	<i>Edukim në Muzikë Bachelor i Arteve 240 ECTS (R)</i>	Astrit Pallaska, Syzana Jakupi Arsim Kelmendi Alba Muçolli Dehiri

KShC fillimisht kishte vendosur që të refuzohen programet e fushës së Arteve për shkak të mungesës së bazës ligjore përkatësisht zbrazëtisë ligjore për këtë çështje (kalimi i afatit të *Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr.02/2019* me datë 31.01.2019).

Mirëpo më pas KShC pas pranimi të *Udhëzimit të ri administrativ (MASHT) 01B-03/2024 për vlerësimin e përshtatshmërisë së bartësve të programeve studimore si dhe programeve nga radhët e komuniteteve jo shumicë në procesin e akreditimit dhe riakreditimit të institucioneve të arsimit të lartë*, nënshkruar me datë 25.07.2024 i cili adreson edhe çështjen e bartësve të programeve të arteve, ka marr në rishqyrtim kërkesën për programet e bashkëngjitura në tabelë me bartësit përkatës dhe pas rishqyrtimit ka arritur në përfundim të riakreditoj programin *Edukim në Muzikë Bachelor i Arteve 240 ECTS (R)* për një periudhë një (1) vjeqare.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 127-të, mbajtur me datë 12.08.2024, ka shqyrtuar dokumentacionin e Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë dhe duke u bazuar në kompetencat ligjore, autorizimet dhe diskrecionin, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë në Komisionin e ankesave, në afatin prej tridhjetë (30) ditësh nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.*

Vendimi iu dërgohet:

- Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi

Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë